



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
NDIHMËS DYTËSORE

SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
DHE DYTËSORE

Nr. 1812 Prot.

Tiranë, më 3.10.2025

NJOFTIM PUBLIK

**“PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR Z. HASAN
DRAZHI, NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.1359(13-2024-5423), DATË 26.11.2024 TË
GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN”**

*Lagjja e Drazhit, Ndërtesa 15, Hyrja 1, fshati Labinot-Mal Guri i zi,
Njësia Administrative Labinot -Mal*

Referuar vendimit nr. 358 regj.them, datë 12.12.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, ku znj. Vasilika Drazhi, është përfituese e Ndihmës Juridike Dytësore, referuar procesit gjyqësor me objekt “*Caktimin nga gjykata të një avokati pa pagesë prej Dhomës së Avokatisë Elbasan, me qëllim përfaqësimin dhe inicimin e një procesi gjyqësor civil pranë kësaj gjykate, Përfashtimin e kërkuarit nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore*”.

Me Vendimin nr. 1359 (13-2024-5423) datë 26.11.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan në procesin me palë paditëse znj. Vasilika Drazhi dhe të paditur z. Hasan Drazhi me objekt “*Zgjidhje e martesës midis palëve Vasilika Drazhi dhe Hasan Drazhi, Kthimin e mbiemrit nga "Drazhi" në atë të vajzërisë "Karaj", lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim paditëses, detyrimin e të paditurit të kontribuojë financiarisht për rritjen dhe edukimin si dhe për ushqimin e fëmijëve në masën 25,000 (njëzetepesëmijë) lekë në muaj për të dy fëmijë*”, ka vendosur:

1. *Pranimin e padisë së palës paditëse Vasilika Drazhi.*
2. *Zgjidhjen e martesës midis palës paditëse Vasilika Drazhi dhe palës së paditur Hasan Drazhi.*
3. *Pala paditëse Vasilika Drazhi, pas zgjidhjes së martesës, të marrë mbiemrin që ka pasur përpara lidhjes së martesës, "Karaj".*
4. *Lënien për rritje dhe edukim të fëmijës të mitur, Mateo Drazhi i datëlindjes 03.01.2011 dhe fëmijës së mitur Melisa Drazhi e datëlindjes 23.06.2012, palës paditëse Vasilika Drazhi.*

5. Pala e paditur, Hasan Drazhi ka të drejtë të takojë dhe të mbajë fëmijët e mitur Mateo Drazhi dhe Melisa Drazhi, në periudhat kohore si më poshtë: -Të komunikojë çdo ditë me fëmijët e mitur, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik në orare të përshtatshme me aktivitetin ditor të tyre. -Të takojë e mbajë fëmijët e mitur të premten e parë dhe të tretë të çdo muaji, nga dita e premte ora 14.00 deri në ditën e diel ora 16.00. -Të mbajë fëmijët e mitur për pushimet verore 30 (tridhjetë) ditë gjatë muajit Korrik ose Gusht të çdo viti kalendarik. -T'i mbajë fëmijët e mitur për pushime dimërore nga data 24 Dhjetor deri në datën 30 Dhjetor të çdo viti kalendarik.
6. Detyrimin e palës së paditur Hasan Drazhi të paguajë detyrimin ushqimor në favor të fëmijëve të mitur Mateo Drazhi dhe Melisa Drazhi në masën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për secilin fëmijë. Ekzekutimi i detyrimit për ushqim do të fillojë nga data e ngritjes së padisë, datë 26.03.2024.
7. Ky vendim, pasi të marrë formë të prerë, përbën titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga Zyra e Përmbarrimit.
8. Një kopje e këtij vendimi, pasi të marrë formë të prerë, i dërgohet Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative Labinot-mal, Bashkia Elbasan, për të bërë ndryshimet përkatëse në regjistrin e gjendjes civile.
9. **Dhe në pikën 9 të dispozitivit të vendimit Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të palës së paditur.**

Në vendim gjykata shpreh që shpenzimet gjyqësore në masën 75 000 lekë të parapaguara nga pala paditëse janë në ngarkim të palës së paditur.

Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas ka likujduar për shërbimet e ofruara avokaten Merita Gjorga me vlerë 40 000 lekë dhe ekspertin Eriona Hoxha në vlerën 35 000 lekë.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Kodit të Proçedurës Civile, **ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit**, në zbatim të Vendimit nr. 1359(13-2024-5423) datë 26.11.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, të shumës prej 75 000 lekë, të parapaguara nga ana jonë për shpërblim avokati dhe eksperti, ofruar për përfituesen e ndihmës juridike dytësore falas znj Vasilika Drazhi.

Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas më NIPT L11704452P.

Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, shërbimi përmbarrimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me z. Hasan Drazhi. Në këto kushte referuar nenit 148 e në vijim të Kodit të procedurës Administrative kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Njësia Administrative Labinot -Mal, si dhe në faqen web të Drejtorisë. Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë. Njoftimi quhet i bërë kur Njësia Administrative Labinot -Mal depoziton në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
NË MUNGESË**

**(DREJTOR I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT
TË NDIHMËS PARËSORE)**

Patricia Pogace

